



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: AKR reagon ndaj kërcënimit të zyrtarëve të AKK

Prishtinë, 1 shkurt 2008

Reagim

Aleanca Kosova e Re, e dënon fuqishëm kërcënimin që i është bërë zyrtarëve të lartë të Agjencionit Anti Korrupsion dhe kërkojmë nga organet kompetente, që menjëherë të marrin masat e duhura, për të ndëshkuar autorët e kësaj vepre.

Kjo ngjarje është refleksion i atyre grupeve që janë të gatshme, të dëmtojnë rëndë institucionet më të rëndësishme në vend dhe Agjencionin Kundër Korrupsion.

Kosova tani po kalon nëpër një fazë shumë të ndjeshme. Kosovarët sot me çdo kusht po mundohen të krijojnë institucione të qëndrueshme, të cilat në vazhdimësi do ta luftojnë korrupsionin dhe dukuritë e tjera të ngjashme.

AKR beson fuqishëm se drejtësia në këtë rast do të jetë e gatshme të dëshmojë aftësitë dhe përgjegjësitë e saj, për të ndëshkuar çdo veprim të tillë, duke ruajtur ndërkohë edhe zinxhirin e funksionimit me Agjencionin Anti Korrupsion.

Aleanca Kosova e Re do të mbështes pa rezervë këtë Agjencion, sepse sot më shumë se kurrë, Kosovës i duhet forcë për të luftuar dukuritë korruptive. Ndërkohë iu bëjmë thirrje institucioneve të Kosovës, që t'i japin mbështetje të pa kursyer, Agjencionit Anti Korrupsion, dhe të krijohen mekanizma mbrojtës për zyrtarët e këtij institucioni.

Kryesia e Aleancës Kosova e Re